

PJESËMARRJA IME NË PROJEKTIN IN BETWEEN NË POLONI

Unë quhem Florentina Qorri dhe aktualisht jam studente e Masterit Profesional në degën Histori-Gjeografi Viti II. Në fund të këtij viti akademik pashë të postuar në faqen e Qendrës së Karrierës të Universitetit programin “In Between”, një workshop, i cili me sa kuptova nga formulari i prezantimit, mbledhte të gjithë studiuesit e rinj që kishin njohuri në fushën e historisë, antropologjisë kulturore, sociologjisë, artit dhe jo vetëm. Këtyre studiuesve të rinj që do të bëheshin pjesë e trajnimit, u krijohesh mundësia të kuptonin se çfarë është historia gojore nëpërmjet trajnimeve specifike në mbledhjen e të dhënave shkencore dhe krahas tyre edhe dokumentimi i dëshmive të intervistave për të njohur historinë e shekullit XX të Evropës. Trajnimi zhvillohej në qytetin e Varshavës, Poloni. Ky ishte informacioni i parë që merrje pasi lexoje njoftimin e shpallur nga programi. Bashkë me informacionin ishin edhe kriteret që duhet të plotëson të çdo aplikant për t`u përzgjedhur.

Doja të aplikoj, sepse ky projekt ishte në të njëjtën linjë me studimet e mia. Si studente e Histori-Gjeografisë e kam kuptuar se sa e rëndësishme është të mësosh nëpërmjet praktikës, të mësosh diçka duke e prekur dhe analizuar nga afër. Por nga ana tjetër, lufta që kisha me veten, më paralizonte të hidhja hapin e radhës, “APLIKIMIN”. Ideja që “je një studente pa përvojë nuk mund të jetë kaq e thjeshtë të jesh pjesë e një projekti të tillë”. Aplikimi në këtë projekt vinte gjithashtu në një kohë të papërshtatshme, kur viti akademik ishte drejt mbylljes dhe për ne studentët kjo perjudhë e vitit është gjithmonë shumë e ngarkuar. Të duhet të dorëzosh të gjitha detyrat e kursit, provimet që duhet të japësh e detyrime të tjera studentore. Të gjitha këto i shtohen dozës së “stresit” që ne kemi dhe janë pretekste që nuk na lënë të mendojmë asgjë tjetër, veçse të mbarojmë sa më mirë vitin akademik.

Kjo ishte historia e pjesës së parë e këtij projekti. Aplikova në limitet e fundit, duke menduar se përzgjedhja do të ishte e limituar, në fushat që përmenda më lart. Aplikimi ishte faza e parë por që për mendimin tim është edhe më e rëndësishmja. Siç thotë një mikja ime : Përpiqu të bësh mirë 50 % tënd dhe pjesën tjetër ia ler mundësisë” me të vërtetë këtë po bëja edhe unë. Po bëja maksimumin tim për të bërë mirë 50 % të punës që më takonte mua.

Pas disa ditëve më erdhi një email ku thuhej: “Jeni pranuar në fazën e dytë të selektimit. Detyra jote e radhës është një intervistë nëpërmjet programit “Skype” me kordinatorën e projektit për të kuptuar edhe njëherë arsyet se përse keni zgjedhur të merrni pjesë në këtë projekt”. Në email ishte vendosur ora dhe adresa e takimit. Intervista kaloi mirë, ishte një prezantim i atyre që kishe thënë me shkrim ku i ritregova edhe njëherë dëshirën për të qenë pjesë e këtij projekti. Edhe nëse nuk përzgjidhesha në fazën përfundimtare nuk do të ishte aq e rëndësishme sa kënaqësia që mora në njohjen e vetvetes, gjatë këtij procesi aplikimi. Nuk po them atë që dështakët zakonisht thonë : “kënaqësi që mora pjesë”, por realisht në këtë fazë kuptova aftësitë e mia, mangësitë e mia, kuptova atë çka doja të bëja në të vërtetë me jetën time. Nëse përgjigja do të ishte negative unë nuk isha e humbur, përkundrazi fitova mundësinë për të kuptuar çfarë kam humbur dhe çfarë duhet të bëj.

“Unë mund të mos isha ende atje ku doja, por isha aty më afër se ç’isha dje.” Përgjigja ishte pozitive nga projekti. Kësaj here ishte dërguar materiali i plotë i orareve dhe ishte e përcaktuar punimi i gjithsecilit anëtar të grupit. Ëorkshopi do të vazhdonte 6-të ditë në qytetin e Varshavës, Poloni, ku çdo ditë përfaqësonte një sesion informimi dhe trajnimi.

- A) Tajnimi mbi hartimin e intervistave dhe analizimin e tyre.
- B) Kontrolli i emocioneve dhe analizimi i intervistave në hapësira dhe situata traumatike
- C) Regjistrimi audio e video dhe arti visual i fotografimit
- D) Dixhitalizimi i materialeve arkivore.

Të gjitha temat do të zhvilloheshin me profesorë historie, antropologjie, etnologjie psikologjie, sociologjie, dhe specialist të artit vizual të Universitetit të Polonisë.

Kjo ishte ajo çka do të zhvillohej në trajnim sa i përkiste anës teorike. Ana praktike do të zhvillohej në bashkëpunim me institucionet e ndryshme në qytetet e Shkodrës dhe Ulqinit. Projekti mbulonte të gjitha shpenzimet e kostos së udhëtimit, fjetjes, ngrënies dhe përdorimit të të gjitha paisjeve, apo materialeve shtesë në institucionin e arkivit dhe bibliotekës. E vetmja gjë që ne duhet të bënim ishte dëshira për të punuar dhe për të njohur njerëz të rinj e kultura të reja. Pjesëmarrja ishte e gjerë duke sjellë një mozaik vlerash dhe kulturash Evropiane dhe kjo ishte ajo çka i`a shtonte më tepër rëndësinë dhe kënaqësinë këtij projekti. Ishin me vërtet dy javë intensive për mua, por edhe dy javë sukcesi. Unë mora informacionin që nuk mund ta merrja edhe sikur të lexoja gjithë librat që tregonin panoramën e shekullit XX të Evropës.

Ajo çka duhet të bëjmë tani është prezantimi i asaj që regjistruam, arkivuar, fotografuar në një konferencë përfundimtare në Berlin, në fillim të muajit Dhjetor, periudhë që përkon me fazën finale të projektit.

Kjo është eksperiencia ime që doja të ndaja me ju miq, një eksperiencë e vërtetë, e prekshme dhe aspak fantazi. Mund të duket edhe e pamundur, mbase, mund të jetë ashtu, në sytë e një studenti. Nga eksperiencia ime mund t’ju them se nëse kristalizoni qartë atë çka doni asgjë nuk mund të jetë fantazi. Këtë shkrim mos e shihni si një mendjemadhësi të një studenteje që është afër asaj që ka dashur, por shikojeni si fjalë motivuese të një studenteje që kishte ndroje fillimisht të trokiste në derën e ndonjë zyrtari për të marrë informacionin që l takonte, të një studenteje që sot e ka kuptuar se sa i madh është potenciali i saj për të ndryshuar mënyrën e të jetuarit dhe të të bërit të gjërave.

-“Fillo aty ku je”

-“Përdor ato që ke”

-“Bëj atë që mundesh”

Me respekt Florentina Qorri